

MENDIM PAKICE

Unë, komisioner Olsi Komici, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica në datën 14.4.2023, nëpërmjet të cilit është vendosur shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit, z. Taulant Tafa, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Vota ime kundër shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit vjen për shkak të konsiderimit të paplotë të hetimit administrativ në lidhje me kriterin e pasurisë dhe refuzimit nga shumica e trupit gjykues të kërkesës sime për riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, konkretisht për verifikimin e mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur, shtetasit D. D., për dhënien hua subjektit të rivlerësimit të shumës 6,000,000 lekë, me kontratën e huadhënies datë 3.3.2005. Kjo lidhet me faktin se në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 10.4.2023, të lëshuar nga shtetasi Xh. Sh., në cilësinë e ortakut të shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe familjarit (dajës) të shtetasit D. D., i cili konfirmon dhënien hua shtetasit D. D. në vitin 2005, shumën 6,000,000 lekë, e cila më pas i është dhënë hua subjektit të rivlerësimit dhe në dijeninë e tij është përdorur për blerjen e bodrumit me sip. 194 m² të ndodhur në Elbasan.

Nisur nga fakti që në seancën dëgjimore u paraqit nga subjekti i rivlerësimit një provë e re (shumica e trupit gjykues duhet të mbante në konsideratë faktin se seanca dëgjimore është pjesë e hetimit administrativ), trupi gjykues kishte detyrimin ligjor që të hetonte në lidhje me vërtetësinë, ligjshmërinë dhe elementet e përmbajtjes së këtij dokumenti dhe, në fund, pas një hetimi të plotë, të arrinte në konkluzionin nëse justifikoheshin ose jo burimet financiare të përdorura nga subjekti i rivlerësimit në këtë investim, për më tepër që vetë subjekti nuk kishte detyrim ligjor të deklaronte qoftë në deklaratat periodike të pasurisë apo edhe në atë *Vetting* burimin e personit tjetër të lidhur.

Moskryerja e një hetimi të plotë dhe shterues në elementin më përcaktues të analizës financiare të subjektit të rivlerësimit penalizon jo vetëm rezultatin e analizës financiare për këtë pasuri, por të gjithë rezultatin e kësaj analize të subjektit të rivlerësimit në vazhdimësi, duke pasur kështu peshën kryesore në shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe duke e bërë vendimin të cenueshëm.

I ndodhur në këto kushte, duke e konsideruar jo të plotë dhe shterues hetimin mbi kriterin e pasurisë në lidhje me elementin kryesor të analizës financiare të subjektit të rivlerësimit, votoj kundër shkarkimit të subjektit të rivlerësimit dhe duke mos pasur alternativë tjetër votimi, votoj për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

Më poshtë po paraqes në mënyrë më të detajuar kundërshtimet e mia në lidhje me vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues, që ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, për të tria kriteret e vlerësimit.

A. Vlerësimi i pasurisë

- 1. Pasuria e paluajtshme truall, me sipërfaqe 200 m² dhe banesë dy kate + bodrum + nënçati, me sipërfaqe 101 m²/kati**

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Tafa, ka deklaruar këtë pasuri të ndodhur në Elbasan si të përfituar 1/3 me trashëgimi ligjore, 1/3 si trashëgimtar ligjor i babait të tij dhe 2/3 me dhurimin e datës 30.9.2011, nga nëna dhe motra të pjesëve takuese të pasurisë trashëgimore. Pasuria është krijuar nga babai. Vlera e deklaruar e banesës: rreth 3,500,000 lekë. Pjesa takuese e subjektit: 100%.

Konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë pasuri

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të ndërtimit të kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Mendimi kundër

Pa përmendur faktet dhe rrethanat e pasqyruara në vendim në lidhje me këtë pikë, por duke marrë në konsideratë edhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, argumentet e mia kundër vendimit të shumicës së trupit gjykues janë si vijon:

a) Në lidhje me vitin e ndërtimit të shtëpisë së banimit:

- Pavarësisht se objekti është deklaruar në DPDFD-në e vitit 2003 si i përfunduar në vitin 2003, bazuar në dokumentacionin e administruar vërtetohet fakti se objekti ka përfunduar dhe është bërë i banueshëm në vitin 2004.
- Marrëdhënia e subjektit ndërtues me pronarin e tokës është një marrëdhënie sipërmarrjeje, që konsiston në porositjen dhe ndërtimin e një sendi të paluajftshëm në të ardhmen. Pra nuk jemi në kushtet e një kontrate shitblerjeje, që në kuptimin klasik me kryerjen e pagesës bëhet dorëzimi i sendit apo edhe anasjelltas. Pagesat për ndërtimin normalisht dhe logjikisht kryhen në vazhdimësi, në varësi të ecurisë së ndërtimit, bazuar në situacionet e punimeve të depozituara nga subjekti ndërtues dhe në akt-piketimet e mbajtura nga Zyra e Urbanistikës që mbahen në faza të caktuara të ndërtimit, duke filluar me hapjen e themeleve dhe që verifikojnë ecurinë e punimeve në terren dhe respektimin e zbatimit të projektit të miratuar nga Zyra e Urbanistikës, ku një pjesë e konsiderueshme e pagesës lidhet me përfundimit e objektit, ndërtimin e tij sipas projektit të miratuar, hartimin e aktit të kolaudimit pas akt-piketimit të fundit, që vërteton përfundimin e ndërtimit të objektit sipas projektit të miratuar dhe, në fund, me lëshimin e lejes së shfrytëzimit nga Zyra e Urbanistikës pranë Bashkisë Elbasan në rastin konkret, që lejon përdorimin e këtij sendi sipas destinacionit të përcaktuar në lejen e ndërtimit dhe regjistrimin e tij në ASHK (ish-ZVRPP), çka lejon që ky send të futet në qarkullimin juridiko-civil. Pra dy dokumentet e fundit, përkatësisht akti i kolaudimit dhe leja e shfrytëzimit, janë garancia teknike dhe ligjore që ky send është ndërtuar në përputhje me ligjin dhe se lejohet të futet në qarkullimin juridiko-civil nëpërmjet regjistrimit të tij në ASHK.
- Konstatohet se akti i kolaudimit është hartuar në datën 8.4.2004, dokument ky që vërteton pikërisht përfundimin e ndërtimit të objektit në përputhje me projektin e miratuar nga Zyra

e Urbanistikës e bashkisë dhe ky dokument lëshohet pikërisht pas mbajtjes së akt-piketimit të fundit që mbahet nga specialistët e Zyrës së Urbanistikës.

- Leja e shfrytëzimit e lëshuar nga Zyra e Urbanistikës e bashkisë mban datën 7.6.2004, dokument i cili vërteton se objekti për banesë është përfunduar konform projektit dhe kushteve urbanistike të miratuara për sheshin e ndërtimit dhe studimit urbanistik pjesor, miratuar me vendimin nr. ***, datë 30.4.2002, të KKRRT-së.
 - Regjistrimi i objektit banesë në ish-ZVRPP-në Elbasan është kryer në datën 14.6.2004, veprim ky që, sikurse e kemi thënë edhe më lart, i jep vlerë ligjore pasurisë dhe e fut atë në qarkullimin juridiko-civil.
 - Në praktikën e lejes së ndërtimit të përcjellë nga Bashkia Elbasan rezultojnë të jenë pjesë e saj edhe dokumente si, certifikata analizash të veçanta për materiale ndërtimi si tulla, hekur dhe çimento, të lëshuara në muajt mars dhe prill 2004. Këto dokumente vërtetojnë në mënyrë të pakundërshtueshme se punime të mirëfillta në objekt ka pasur edhe pas vitit 2003, konkretisht në vitin 2004.
 - Të gjitha procedurat e ndjekura për ndërtimin e objektit banesë janë bazuar pikërisht në ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.
 - Nisur nga sa më lart, krijohet bindja dhe është provuar me dokumentacion se pasuria e paluajtshme truall me sip. 200 m² dhe banesë dy kate + bodrum + nënçati me sip. 101 m²/kati, ka filluar së ndërtuari në vitin 2002 dhe ka përfunduar në vitin 2004.
- b) Në lidhje me rezultatin e analizës financiare për këtë pasuri dhe përfshirjen ose jo të kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit në datën 24.9.2004, në shumën 2,000,000 lekë, në “Alpha Bank”, si burim krijimi për këtë pasuri:
- Sikurse e kemi sqaruar edhe më sipër, në rastin konkret jemi përpara një marrëdhënieje sipërmarrjeje ku subjekti ndërtues merr përsipër të ndërtojë një send të paluajtshëm në të ardhmen përkundrejt pagesave që do të kryhen nga ana e investitorit/porositësit. Kryerja e pagesave, përgjithësisht ecën paralelisht me ecurinë e ndërtimit të sendit dhe konfirmimin e kësaj ecurie nga Zyra e Urbanistikës në bashki. Pavarësisht nëse është e përcaktuar ose jo në një akt të shkruar mënyra e pagesës, praktika na ka treguar se një pjesë e konsiderueshme e çmimit për ndërtimin e sendit paguhet nga ana e investitorit me lëshimin e aktit të kolaudimit dhe lejes së shfrytëzimit, dy dokumente këto që konfirmojnë dhe garantojnë porositësin/investitorin se ndërtimi është kryer në respektim të projektit dhe kushteve urbanistike të përcaktuara në sheshin e ndërtimit, studimit urbanistik dhe lejes së ndërtimit, si dhe në respektim të legjislacionit përkatës, duke e përfshirë kështu sendin ligjërisht në qarkullimin juridiko-civil. Kjo të krijon bindjen se një pjesë e çmimit të ndërtimit është paguar nga investitori në vitin 2004.
 - Të ndodhur në kushtet e një marrëdhënieje mirëbesimi, është mëse e qartë që subjekti ndërtues e ka lejuar subjektin e rivlerësimit, në këtë rast investitorin, që të regjistrojë

ndërtimin e ri në ish-ZVRPP-në Elbasan, me qëllimin kryesor vendosjen e kësaj pasurie si garanci për të marrë kredi me qëllim shlyerjen e vlerës së plotë të ndërtimit. Regjistrimi dhe vendosja si garanci hipotekore e një trualli dhe e një ndërtese të ndërtuar mbi të, absolutisht që do të ishin për bankën një garanci e mjaftueshme për të garantuar pagimin e kredisë nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur me të.

- Në lidhje me faktin se kredia është marrë me qëllim rikonstruksion banese, kam bindjen se ajo është përdorur për përfundimin e ndërtimit të saj ose për shlyerjen e detyrimeve ndaj subjektit ndërtues për punime të kryera për përfundimin e banesës, pikërisht përgjatë vitit 2004.
- Pavarësisht se në dokumentin e kredisë është pasqyruar si qëllim i marrjes së saj rikonstruksioni i banesës, ky përcaktim në kontratë nuk ka logjikë, për sa kohë që objekti kishte përfunduar si në aspektin teknik të ndërtimit, ashtu edhe në aspektin ligjor me regjistrimin e tij në ish-ZVRPP-në Elbasan.
- Sa më sipër, krijohet bindja se kredia e marrë në vitin 2004 është marrë me qëllimin e vetëm për kryerjen e pagesave për përfundimin e objektit ose shlyerjen e detyrimeve për punime të kryera nga subjekti ndërtues, veprime këto të ndodhura përgjatë vitit 2004, për rrjedhojë shuma prej 1,872,900 lekësh, e tërhequr *cash* në datën 5.10.2004, duhet të përfshihet në analizën financiare të kryer për këtë pasuri, duke sjellë si pasojë përmbyshjen e balancës financiare negative prej -1,691,500 lekësh dhe kalimin në balancë pozitive.

Në përfundim, për pasurinë e paluajtshme truall me sip. 200 m² dhe banesë dy kate + bodrum + nënçati me sip. 101 m²/kati, arrij në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të saktë dhe ka burime financiare të ligjshme të mjaftueshme financiare për kryerjen e këtij investimi.

2. Pasuria e paluajtshme bodrum, me sipërfaqe 194 m², ndodhur në Elbasan

Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar: *“Bodrum me sip. 194 m², i ndodhur në pallatin nr. ***, lagjja ****”, Elbasan, në shumën 14,000,000 lekë, me pjesë takuese ½, datë krijimi të pasurisë 28.2.2005.”* Gjithashtu, në detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, ka deklaruar kontratë huaje në shumën 6,000,000 lekë, me afat 3-vjeçar, pa interes, datë 3.3.2005, marrë shtetasit D. D..

Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 28.2.2005, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi D. D. kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. pasurinë bodrum me sip. 194 m², në lagjen “****”, Elbasan, pallati nr. ***. Në këtë kontratë shitblerjeje është deklaruar nga palët që çmimi i blerjes prej 14,000,000 lekësh është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e kësaj pasurie me kontratë shitjeje nr. ***, datë 27.5.2008, në shumën 200,000 euro (me pjesë takuese ½). Në të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari private dhe/ose publike, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *“të ardhura nga shitja e ½ e bodrumit, sipas kontratës së shitjes së datës 27.5.2008, në vlerën 100,000 euro...”*,

ndërsa në detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë ka deklaruar “shlyerje detyrimi ndaj shtetasit D. D., sipas kontratës së huadhënies datë 3.3.2005, në shumën 6,000,000 lekë.”

Mendimi kundër

Në lidhje me mundësinë e krijimit të ½ pjesë në pasurinë e paluajtshme të llojit “bodrum” me sip. 194 m², blerë në datën 28.2.2005, për çmimin 14,000,000 lekë, shumica e trupit gjykues e ka nxjerrë subjektin e rivlerësimit me një pamundësi financiare prej -6,906,367 lekësh, për pagimin e pjesës së tij takuese prej 7,000,000 lekësh, duke mos marrë në konsideratë dy burimet e krijimit, konkretisht: (a) huan prej 6,000,000 lekësh, marrë ortakut të tij, prej ½ pjesë në këtë bashkinvestim, shtetasit D. D., sipas kontratës së huadhënies datë 3.3.2005; dhe (b) 1,000,000 lekë të siguruara nga kredia bankare prej 5,000,000 lekësh.

Në lidhje me këtë pikë, argumentet e mia kundër vendimit të shumicës së trupit gjykues janë si vijon:

Fillimisht më duhet të sqaroj se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor të justifikojë burimin e ligjshëm për pjesën e tij të investimit prej ½ pjesë, që i korrespondon shuma 7,000,000 lekë.

a) Në lidhje me burimin e huas së dhënë subjektit të rivlerësimit nga personi tjetër i lidhur D. D., në shumën 6,000,000 lekë, sikurse e kam theksuar që në fillim të këtij dokumenti, shumica e trupit gjykues duhet të kishte pranuar kryerjen e hetimit administrativ mbi mundësitë financiare të huadhënësit Xh. Sh. (si individ apo edhe si ortak në shoqërinë “**”). Kjo për faktin se personi tjetër i lidhur me subjektin, shtetasi D. D., ka hartuar një deklaratë noteriale, ku deklaroi se shuma prej 6,000,000 lekësh, dhënë hua subjektit të rivlerësimit, ishte marrë hua pikërisht nga daja i tij, shtetasi Xh. Sh., i cili ushtron aktivitet tregtar nëpërmjet shoqërisë “****”. Gjithashtu, fakti i huadhënies shtetasit D. D. konfirmohet po me deklaratë noteriale nga shtetasi Xh. Sh.. Të dyja këto deklarata u paraqitën nga subjekti dhe u administruan nga Komisioni në cilësinë e provës në seancën dëgjimore.**

- Të ndodhur para këtyre dy dokumenteve ligjore që kondiciononin analizën financiare në lidhje me këtë pasuri, si dhe ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura nga ana e subjektit në kryerjen e këtij investimi, trupi gjykues kishte detyrimin ligjor të riçelto hetimin administrativ dhe të kryente hetimet e duhura në lidhje me mundësitë financiare të shtetasit Xh. Sh. (si individ apo si subjekt tregtar) për të justifikuar këtë huadhënie. Kjo lidhet edhe me faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrim ligjor të deklarojë burimin e krijimit të personit tjetër të lidhur. Vetëm pasi të ishin kryer hetime mbi provat e vëna në dispozicion të Komisionit nga ana e subjektit të rivlerësimit, shumica e trupit gjykues, pavarësisht rezultatit, do të mund të përdorte më pas si armë në dhënien e argumenteve dhe arritjen e konkluzioneve bindjen e brendshme dhe logjikën.
- Sa më sipër, jam i detyruar të konkludoj në lidhje me këtë burim bazuar në gjendjen në të cilën ndodhen faktet dhe rrethanat, si dhe në shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga vetë subjekti i rivlerësimit.

- Nga verifikimi i ekstraktit historik të regjistrit tregtar për subjektin “***” sh.p.k.¹, për aq sa është e mundur, konstatohet se kjo shoqëri është themeluar që në datën 28.2.1997, ku shtetasi Xh. Sh. ka qenë aksioner me 34% dhe në vitin 2002 është bërë aksioner me 50%. Konstatohet se kjo shoqëri ka zgjeruar aktivitetin dhe ka fuqizuar situatën e saj financiare në vazhdimësi. Vlen të përmendim se në bazë të këtij informacioni konstatohet se në vitin 2012 vlera e kapitalit të shoqërisë rezulton të jetë 52,7000,000 lekë, ndërsa në vitin 2019 shkon në vlerën 196,150,000 lekë, kur është emëruar edhe administrator huadhënësi Xh. Sh., i cili gjithashtu figuron edhe ortak me 33,33%, që i korrespondon vlera 65,383,333.33 lekë. Sa më sipër, në analizë të fakteve, rrethanave dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, për aq sa është e mundur, krijohet bindja se shtetasi Xh. Sh. ka pasur mjaftueshëm të ardhura financiare për t’i mundësuar dhënien e huas shtetasit D. D., shumë e cila më pas i është dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

b) Në lidhje me kredinë bankare të përfituar nga “Alpha Bank” nga subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi D. D., në shumën 5,000,000 lekë, nuk jam dakord me moskonsiderimin e shumës 1,000,000 lekë si pjesë e shumës 7,000,000 lekë të paguar nga subjekti për blerjen e ½ pjesë të pasurisë bodrum, si dhe me llogaritjen e gjysmës së kredisë prej 2,500,000 lekësh dhe interesave përkatëse si shpenzim në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, duke argumentuar si vijon:

- Kredia prej 5,000,000 lekësh, si pjesë e çmimit të blerjes së kësaj pasurie, është pranuar dhe konfirmuar gjithashtu nga vetë pala shitëse, z. P. K., me deklaratën noteriale të datës 11.4.2022.
- Hartimi i kontratës së shitblerjes së bodrumit, në datën 28.2.2005, me detyrime të përmbushura nga të dyja palët, krijon bindjen se është hartuar e tillë me qëllimin për të mundësuar marrjen e kredisë nga subjekti dhe shtetasi D. D. dhe vendosjen si kolateral të po kësaj pasurie, për të mundësuar garantimin e kthimit të kredisë. Ky argument përforcohet edhe nga fakti se kredia është marrë brenda dy muajve nga data e lidhjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë.
- Vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në ILDKPKI, me procesverbalin e datës 7.1.2015, pra kohë më parë se të miratohej ligji nr. 84/2016, se ka paguar 1,000,000 lekë nga kredia e marrë, si pjesë e çmimit 7,000,000 lekë. Në lidhje me këtë pikë duhet të mbajmë parasysh përcaktimet ligjore në ligjin nr. 84/2016, sipas të cilit deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI kanë vlerën e provës.
- Me fuqi të plotë provuese është edhe vërtetimi i “Alpha Bank”, datë 16.1.2015, që konfirmon dhënien e kredisë, me objekt financimi “blerje njësie lokale”.
- Sa më sipër, në lidhje me pasurinë bodrum, bazuar në provat, faktet, rrethanat dhe shpjegimet e subjektit, krijohet bindja se ½ pjesë takuese e çmimit të blerjes prej 7,000,000 lekësh, që i korrespondon subjektit të rivlerësimit, është paguar me burime të ligjshme

¹ Shihni faqen zyrtare të QKB-së, ekstraktin e shoqërisë dhe bilancet.

financiare, konkretisht 6,000,000 lekë dhënë hua subjektit nga personi tjetër i lidhur D. D., si dhe 1,000,000 lekë nga kredia prej 5,000,000 lekësh marrë në “Alpha Bank” nga subjekti dhe shtetasi D. D. dhe, si pasojë e këtij konkluzioni, rrëzohet edhe konkluzioni i shumicës së trupit gjykues për ngarkimin si shpenzim subjektit të ½ të shumës së kredisë prej 2,500,000 lekësh.

c) Në lidhje me shlyerjen e pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit në kredinë bankare prej 5,000,000 lekësh, që i korrespondon shuma 15,400 euro, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, krijoj bindjen mbi vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit se kredia është shlyer nga një paradhënie e blerësit të pasurisë bodrum, për arsye se:

- Pasuria bodrum është vendosur garanci nga bashkëpronarët Taulant Tafa dhe D. D. për marrjen e kredisë prej 5,000,000 lekësh në “Alpha Bank” dhe për t’u mundësuar shitja e kësaj pasurie fillimisht duhej shlyer pjesa e mbetur e kredisë dhe të bëhej çlirimi i saj nga barra hipotekore.
- Kredia rezulton të jetë shlyer në datën 23.5.2008 me fonde *cash* nga jashtë bankës dhe brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore, pas 4 ditësh, është proceduar me shitjen e kësaj me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 27.5.2008, për çmimin 200,000 euro.
- Në kontratë nuk përcaktohet që shuma 200,000 euro të jetë paguar ditën e firmosjes së kontratës.
- Subjekti nuk kishte detyrim ligjor të deklaronte paradhënien nga ana e blerësit të objektit si burim për shlyerjen e kredisë, për sa kohë që shlyerja e kredisë dhe blerja e objektit kanë ndodhur brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore, brenda 4 ditëve, dhe brenda të njëjtit vit dhe burimi fundor i shlyerjes së kredisë mbetet të jetë pa diskutim një pjesë e shumës së përfituar nga shitja e objektit, prej 200,000 euro.
- Sa më lart, në analizë financiare, shlyerja e kredisë në masën 15,400 euro nuk duhet t’i llogaritet subjektit të rivlerësimit si shpenzim nga të ardhura të tjera të subjektit, por si zbritje nga shuma 100,000 euro, kjo ½ pjesë e çmimit të shitjes së pasurisë bodrum për çmimin total 200,000 euro.

d) Në lidhje me shitjen e pasurisë bodrum me kontratën e shitblerjes datë 27.5.2008, në shumën 200,000 euro dhe mosdeklarimin e shumës prej 100,007 euro të përfituar nga subjekti i rivlerësimit si rezultat i kësaj shitjeje, nuk jam dakord me konkluzionin e shumicës së trupit gjykues se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me këto të ardhura dhe mosdeklarimin e tyre nga ana e tij në deklaratën *Vetting*, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84.2016.

- Subjekti ka provuar bindshëm dhe me prova shitjen e pasurisë bodrum blerëses H. L., me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 27.5.2008, për çmimin 200,000 euro dhe pagesën e çmimit të blerjes nga ana e blerëses, fakt ky i pasqyruar qartë në kontratën e shitblerjes, si dhe përdorimin e pjesës së tij takuese, konkretisht për pagesën e pjesës së mbetur nga pjesa e tij e kredisë në shumën 15,400 euro, 6,000,000 lekë për kthimin e huas marrë shtetasit D.

D. dhe pagesën e shpenzimeve jetike përgjatë periudhës dyvjeçare kur ka qenë i pezulluar nga detyra, duke shuar çdo dyshim për fshehjen e këtyre të ardhurave.

- Shpenzimet jetike nuk janë shpenzime të dedikuara për një qëllim të caktuar dhe që do të duhet të deklaroheshin nga ana e subjektit të rivlerësimit kur ato të kalonin limitin 500,000 lekë apo edhe 300,000 lekë, sipas përcaktimeve ligjore. Deklarimi i burimeve për shpenzimet jetike nuk është detyrim ligjor.

3. Automjet tip “**”**

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Automjet i blerë sipas kontratës së shitblerjes datë 10.5.2012, përkundrejt shumës 1,000 euro. Burimi i krijimit: kursimet e ardhurave familjare. Pjesa takuese: 100%.*”

Në DIPPV/2013 subjekti ka deklaruar: “*Autoveturë e markës “****”, tip ***, vit prodhimi 2002, në shumën 1,000 euro, duke deklaruar kontratën e shitblerjes së datës 10.5.2012 dhe zhdoganimin dhe regjistrimin në shtator të vitit 2013.*”

Në lidhje me këtë pasuri, shumica e trupit gjykues ka konkluduar se:

Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor mundësinë financiare për blerjen e automjetit tip “****”, krijimin e depozitës në “Raiffeisen Bank” në emër të bashkëshortes në datën 20.2.2012, si dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara, deklaruar dhe llogaritura, duke rezultuar me bilanc negativ prej -421,186 lekësh, për harkun kohor 1.1.2012 – 10.5.2012.

Veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me procedurat e zhdoganimit për këtë pasuri të luajtshme përbëjnë zgjedhje të cilat nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, në kuptim të parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Mendimi kundër

Nuk jam dakord me argumentin që subjekti me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut, për arsye se në një gjykim dhe vlerësim tërësor të këtij transaksioni dhe procedurës së zhdoganimit bëhet fjalë për një automjet të blerë për vetëm 1,000 euro dhe se çdo pagesë taksash doganore dhe tatimore është e bazuar në dokumentacionin përkatës që ndodhet edhe në DPSHTRR.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna prej tij dhe me dokumentacionin e paraqitur, ka qenë bindës në lidhje me faktin se: “*Pretendimi i Komisionit se veprimet për zhdoganimin e mjetit janë kryer me paraqitjen e dokumenteve fiktivë nuk provohen në asnjë rast. Përkundrazi, praktika e plotë e dosjes së mjetit e dërguar nga DPSHTRR Elbasan provojnë se nuk ka asnjë devijim nga detyrimet doganore apo tatimore në lidhje me regjistrimin e mjeteve. Është e provuar nga këto akte se dogana e mjetit është paguar në vlerë të plotë referuar faturës tatimore të lëshuar nga shitësi në origjinë i mjetit dhe se nuk ka asnjë veprim të kryer nga subjekti i rivlerësimit me qëllim uljen e këtij detyrimi. Injëjti qëndrim vlen edhe për pretendimin e Komisionit se procedura e hyrjedaljes ka pasur për qëllim të shmangë çmimin real të blerjes së automjetit. Fakti që vlera e paguar si detyrim doganor është pothuajse sa gjysma e vlerës së kontratës së blerjes së mjetit provon se*

detyrimet doganore nuk janë paguar në bazë të vlerës së faturës së blerjes, por në bazë të çmimit të referencës, fakt që provon se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk ka shmangie nga detyrimet doganore.”

Është diçka tashmë e ditur se në Republikën e Shqipërisë, në vite të hershme, kanë hyrë dhe janë shitur automjete të vjedhura në vendet e tjera. Qytetarëve të ndryshëm të Republikës së Shqipërisë nuk u është mundësuar dalja jashtë territorit të vendit, për arsye se u janë bllokuar automjetet në pika të ndryshme doganore ku është raportuar se automjeti ka rezultuar i vjedhur në një shtet të caktuar. Kështu që në atë kohë kjo ka qenë një mënyrë që blerësi përpara se të blinte automjetin kërkonte nga shitësi garanci që automjeti mund të lëvizte pa probleme edhe jashtë territorit të vendit dhe e vetmja mënyrë ka qenë që automjeti të testohej në një pikë doganore, sikurse është aplikuar edhe në këtë rast.

Fakti që subjekti i rivlerësimit nuk u është shmangur, përkundrazi ka paguar detyrimet doganore dhe tatimore në lidhje me këtë automjet, pavarësisht se mund të presupozohet se ato janë kryer me vonesë, por brenda periudhës së duhur kohore nga data e zhdoganimit të automjetit, nuk e vë subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84.2016, që të ketë cenuar besimin e publikut.

4. Analiza e treguesve financiarë

Në përfundim të analizës financiare të kryer, ka rezultuar se për periudhën e deklaramit subjekti dhe personi i lidhur kanë qenë në pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, duke rezultuar me balanca negative, përkatësisht për vitin 2005 në vlerën -7,665,454 lekë, për vitin 2006 në vlerën -1,173,231 lekë, për vitin 2007 në vlerën -1,173,297 lekë, për vitin 2008 në vlerën 622,993 lekë, për vitin 2012 në vlerën -263,588 lekë dhe për vitin 2016 në vlerën 182,892 lekë.

Mendimi kundër

Në lidhje me rezultatin e arritur nga shumica e trupit gjykues, nuk jam dakord, duke argumentuar se, marrë për bazë provat, deklaratat e pasurisë ndër vite, të cilat referuar ligjit nr. 84/2016 kanë vlerën e provës, deklaratën *Vetting* dhe për sa kam argumentuar më sipër, subjekti i rivlerësimit ka reduktuar mjaftueshëm analizën e treguesve financiarë, duke e sjellë rezultatin përfundimtar të saj në kufijtë e aplikimit të parimit të proporcionalitetit, çka nuk e vendos subjektin në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për arsye se shumica e trupit gjykues duhet të kishte marrë në konsideratë dhe të përfshinte në analizën financiare:

- a) kredinë e marrë në “Alpha Bank”, në shumën 2,000,000 lekë, në datën 24.9.2004, për ndërtimin e shtëpisë së banimit;
- b) huan e marrë ortakut të tij në investim, shtetasit D. D., në shumën 6,000,000 lekë, me kontratën e huadhënies datë 3.3.2005, si hua me burim të ligjshëm financiar;
- c) vlerën 1,000,000 lekë nga huaja e marrë në “Alpha Bank” me kontratën e kredisë bankare datë 21.4.2005 dhe jo ½ e saj në shumën 2,500,000 lekë;

- d) të ardhurat nga qiraja prej 100,000 lekë/muaj, për arsye se qiramarrësi ka qenë një subjekt tregtar dhe jo një individ dhe sipas legjislacionit tatimor për këto raste përgjegjësia për pagesën e detyrimeve të qirasë i kalon me ligj qiramarrësit;
- e) paradhënien nga blerësja e pasurisë bodrum, shtetasja H. L., në shumën 15,400 euro, me qëllim shlyerjen e pjesës së mbetur të huas prej 15,400 euro, në datën 23.5.2008, me qëllim çlirimin e pasurisë nga barra hipotekore dhe realizimin e kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie vetëm 4 ditë më pas, pikërisht në datën 27.5.2008;
- f) marrjen në konsideratë si e ardhur e pjesës së tij takuese prej ½ në çmimin e shitjes së pasurisë bodrum, prej 100,000 euro në datën 27.5.2008 dhe llogaritjen e një pjese nga kjo shumë si shpenzime jetese në dy vitet e mëvonshme kur subjekti ka qenë i pezulluar nga detyra e gjyqtarit, duke marrë në konsideratë edhe faktin se subjekti nuk ka detyrim ligjor të deklarojë burimin e shpenzimeve të jetesës, përveçse kjo llogaritjet nga ana e Komisionit bazuar në buletinet përkatëse të INSTAT-it.

Gjetje të tjera nga hetimi administrativ

5. Në lidhje me automjetin tip “*”, përdorur nga subjekti i rivlerësimit, shumica e trupit gjykues ka konstatuar se:**

- i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar, si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në pyetësonin standard, përdorimin nga ana e tij të automjetit tip “***”, me targa ***.
- ii) Nuk provohet përdorimi i këtij automjeti nga shtetasi R. B.
- iii) Referuar policës së sigurimit të datës 14.9.2016, shtetasi R. B. është përdorues i automjetit tip “***”, me targa ***, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

Dhe në përfundim të hetimit ka arritur në përfundimin se: *“Trupi gjykues analizoi të gjitha të dhënat që rezultojnë nga burimet e tjera të provave, sipas përcaktimeve të posaçme të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të një sërë rrethanash, të cilat kanë rezultuar nga hetimi dhe që nuk mund të injorohen e të konsiderohen si joekzistente në kushtet kur burojnë nga burime të njohura të provës, të tilla si: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar, si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në pyetësonin standard, përdorimin nga ana e tij të automjetit tip “***” me targa ***; (ii) shkëmbimit të përdorimeve të automjeteve me shtetasin R. B., vlerëson se faktet çmuar në raport me njëra-tjetrën çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, ndodhet në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.”*

Mendimi kundër

Në lidhje me gjetjet dhe përfundimin e trupit gjykues në lidhje me përdorimin e automjetit tip “***” nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk jam dakord, duke argumentuar si vijon:

- a) Rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 13.11.2016 – 1.9.2019, ka përdorur vetëm 4 herë këtë automjet, pra nuk provohet një përdorim në vazhdimësi i këtij automjeti nga ana e subjektit.

- b) Në pyetësozin standard subjekti ka pohuar se ka përdorur automjete, por pa dhënë specifikime, të cilat i ka saktësuar kur i janë kërkuar nga Komisioni.
- c) Shumica e trupit gjykues nuk ka provuar me dokumentacion ekzistencën e ndonjë police sigurimi në emër të subjektit për këtë automjet. Vetëm ekzistenca e një dokumenti të tillë do të mund të provonte përdorimin e automjetit në vazhdimësi nga ana e subjektit.
- d) Qëllimi i ligjit nr. 84/2016 dhe i pyetësorit standard ka qenë deklarimi i pasurive që përdoren në vazhdimësi dhe pa ndërprerje nga ana e subjektit dhe jo ato që përdoren në raste shumë të rralla, në mënyrë sporadike nga ana e subjekteve të rivlerësimit.
- e) Ndryshe nga sa konkludon shumica e trupit gjykues se **nuk provohet përdorimi** i automjetit tip “****” me targa ***, nga shtetasi R. B., kjo gjë është e provuar si në kontekstin e pronësisë me kontratën e shitblerjes datë 3.10.2016, me blerës shtetasin R. B., ashtu edhe me policat e sigurimit të lidhura për këtë automjet në emër të po këtij shtetasi.
- f) Fakti që shtetasi R. B. ka një policë sigurimi për automjetin tip “****” me targa ***, në pronësi të subjektit, nuk do të thotë që për rrjedhojë automjeti tjetër me targa *** të jetë pasuri e fshehur e subjektit në emër të këtij shtetasi.
- g) Legjislacioni shqiptar nuk parashikon ndalesë ligjore për një shtetas që ai s’mund të ketë automjet në pronësi dhe në të njëjtën kohë edhe automjet në përdorim, qoftë kjo edhe për një periudhë të caktuar kohore.

Sa më lart, është mëse e qartë se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet as në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke mos cenuar besimin e publikut, dhe as në kushtet e germës “c”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duke mos u vërtetuar as me prova dhe as në aplikim të bindjes së brendshme ekzistenca e ndonjë pasurie të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

6. Përdorimi i automjetit të shoqërisë “**” sh.p.k.**

Në lidhje me konkluzionin e shumicës së trupit gjykues se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit dhe ka cenuar besimin e publikut, në analizë të provave, fakteve vendimmarrjes së shumicës së trupit gjykues, si dhe parashtrimeve të subjektit, sqarohj se:

- a) Si ligji nr. 9367/2005, ashtu edhe Kodi i Procedurës Civile, në interpretim të tyre në lidhje me trajtimin e situatës së konfliktit të interesit i japin një rëndësi të veçantë faktit se nuk duhet abuzuar nga zyrtari publik në lidhje me këtë kërkesë, me argumentin se gjithmonë duhet mbajtur në konsideratë fakti se prevalon zbatimi i detyrës.
- b) Procesi gjyqësor i vitit 2011 është zhvilluar dhe përmbyllur shumë kohë përpara përdorimit të automjetit të kësaj kompanie nga ana e subjektit të rivlerësimit (datë 17.4.2016) dhe ky fakt, duke mbajtur në konsideratë edhe praktikën e Kolegjit, e zeron mundësinë e ndodhjes në situatë konflikti interesi. Në lidhje me këtë situatë, përtej çdo hamendësimi, mbaj në konsideratë se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit nuk është ankimuar nga pala humbëse, duke u dakordësuar kështu me këtë vendim, veprim ky i cili nuk na jep mundësinë as ta hetojmë vendimmarrjen e subjektit nën dritën e vlerësimit profesional.

c) Vendimmarrja e dytë e subjektit të rivlerësimit ka të bëjë me lëshimin e një urdhri ekzekutimi, një procedurë kjo krejt formale dhe rutinore, që kryhet me qëllim ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, pa qenë i nevojshëm një kujdes i shtuar nga ana e subjektit nëse ndodhet në situatë konflikti interesi apo cenon besimin e publikut. Vetëm në rast se subjekti i rivlerësimit do të ishte gjyqtari që do të kishte marrë vendim në gjyqin e themelit, për të cilin është kërkuar lëshimi i urdhrin të ekzekutimit, atëherë do të mund të diskutonim për ekzistencën e ndonjë situatë konflikti interesi apo/edhe cenim të besimit të publikut, si dhe në kuadër të vlerësimit profesional në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

Sa më lart, arrij në konkluzion se subjekti i rivlerësimit nuk ka gjykuar në situatë konflikti interesi në të dyja rastet dhe, parë kjo vendimmarrje me sytë e publikut, vlerësoj se edhe në rast se do të supozonim për përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit ajo nuk do të rrinte të ngrihej deri në atë nivel saqë ndaj tij të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

7. Përdorimi i automjetit në pronësi të shtetasve K. dhe V. B.

Në lidhje me konkluzionin e Komisionit se veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me përdorimin e automjetit të shtetasit V. B., pasi kishte shqyrtuar para këtij udhëtimit çështjen penale nr. ***, datë 12.11.2012, kanë cenuar besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, argumentoj se konkluzioni i shumicës së trupit gjykues është i nxituar dhe rezultat i veprimeve hetimore jo të plota e konkludente, kjo për faktin se automjeti rezulton në pronësi të dy vëllezërve K. dhe V. B. dhe minimalisht subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se nuk ka dhënë shpjegime, duhej të ishte pyetur në seancë dëgjimore se me kë prej vëllezërve kishte shoqëri dhe cilit prej tyre i ka marrë automjetin në përdorim. Vetëm pas qartësimit të kësaj situatë, hetimi do të konsiderohej i plotë dhe konkluzioni i shumicës së trupit gjykues do të ishte i drejtë dhe i pranueshëm edhe nga ana ime, sido që të ishte ai.

B. Kontrolli i figurës

Në lidhje me kriterin e figurës, shumica e trupit gjykues ka arritur në konkluzionin se: *“Komisioni, pas hetimit të kryer, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjet e arsytuara më lart për vlerësimin e kontrollit të figurës, dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve e dhëna nga subjekti, krijoi bindjen se informacionet që disponoheshin në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ishin bazuar në fakte dhe rrethana konkrete...”*

Në përfundim, në këndvështrimin e përgjithshëm edhe nëse përfundimi i arritur nga trupi gjykues në pikën 11.1. të këtij vendimi nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Taulant Tafa, trupi gjykues vlerëson se mospërbushja e rregullt e detyrës nga subjekti i rivlerësimit cenon pastërtinë e figurës së subjektit dhe shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.”

Mendimi kundër

Në lidhje me sa më lart, provat, analizën në vendim dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, argumentoj si vijon:

- a) Në lidhje me procedimin penal nr. *** dhe kërkesën për lirimin para kohe me kusht nr. ***, datë 24.12.2018, vlerësoj se në tërësinë e tyre, subjekti i rivlerësimit ka dhënë mjaftueshëm shpjegime² të bazuara në prova dhe bindjen e tij të brendshme që justifikojnë vendimmarrjen e tij.
- b) Në lidhje me çështjen penale nr. ***, përtej faktit se bazuar në pikën 4 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale, vlerësoj si rrethanë lehtësuese faktin se edhe vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës ka qenë pothuajse i njëjtë me atë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku subjekti ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupës gjykuese dhe jo të relatorit të çështjes. Duke qenë se vendimet e dy shkallëve të para kanë qenë pothuaj të njëjta, vlerësoj se më së shumti bëhet fjalë për një perceptim, gjykim dhe vlerësim ligjor të tillë, jo vetëm të subjektit të rivlerësimit, por edhe të anëtarëve të tjerë të trupave gjykuese si në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ashtu edhe në Gjykatën e Apelit Durrës, duke e sfumuar kështu maksimalisht pistën e korrupsionit dhe, për rrjedhojë, aplikimin e pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nga njëra anë dhe nga ana tjetër kjo problematikë nuk arrin të ngrihet deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 5 të nenit 61 të po këtij ligji.

C. Vlerësimi i aftësive profesionale

Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, shumica e trupit gjykues ka arritur në konkluzionin se: *“Komisioni, pasi analizoi si më sipër lidhur me dosjet e referuara në vlerësimin profesional dhe për denoncimet sipas ligjit nr. 84/2016, dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti, vlerëson se bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson se në kuptim të nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procedura e rivlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm. Në këtë drejtim, neni 72 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përcaktuar indikatorët mbi të cilët vlerësohen aftësitë profesionale të gjyqtarit. Në pikën 2 të kësaj dispozite parashikohet si indikator aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin. Mangësitë e konstatuara në vendimet e subjektit afektojnë indikatorin e parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016. Edhe nëse ato nuk do të mjaftonin për të kualifikuar subjektin të paaftë profesionalisht, sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, referuar problematikave dhe mangësive të evidentuara, në një vlerësim tërësor të rrethanave dhe procedurave ato do të ishin të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit*

² Shihni parashtrimet e detajuara të subjektit të rivlerësimit.

ndodhet në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 lidhur me këtë komponent.”

Mendimi kundër

Në lidhje me këtë konkluzion të shumicës së trupit gjykues, vlerësoj se duke marrë në konsideratë provat, shpjegimet e dhëna nga subjekti, si dhe faktin se në shumicën dërrmuese të rasteve:

- a) vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit ka qenë sipas kërkimeve të prokurorit të çështjes;
- b) vendimet kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar si nga prokurori ashtu edhe nga palët;
- c) edhe në rast kur vendimmarrja e trupës gjykuese, pjesë e së cilës ka qenë edhe vetë subjekti, është prishur nga Gjykata e Lartë, ajo ka qenë e njëjtë ose thuajse e njëjtë me vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës,

– problematikat e konstatuara nuk arrijnë të ngrihen deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke vlerësuar se subjekti arrin një nivel minimal në vlerësimin e aftësie profesionale (pika 1/c e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016), vendimmarrje kjo e cila mund të shoqërohej edhe me dërgimin e ndonjë çështjeje për vlerësim disiplinor në ILD, bazuar në pikën 4 të nenit 59 (problematika mbi konfliktin e interesit).

Konkluzion përfundimtar

Në përfundim, trupi gjykues ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Taulant Tafa, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Mendimi kundër

Në përfundim, pasi mora në konsideratë provat, faktet, rrethanat, qëndrimin e shumicës së trupit gjykues, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, nuk jam dakord me vendimmarrjen e shumicës për shkarkimin nga detyra të subjektit, për arsye se:

- a) Në lidhje me kriterin e pasurisë:
 1. E konsideroj të paplotë hetimin administrativ në lidhje me kriterin e pasurisë në elementin kryesor të saj, huadhënien e personit tjetër të lidhur, shtetasi D. D., në shumën prej 6,000,000 lekësh (që përbën edhe arsyen kryesore që unë të mos votoj për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit), element ky që impakton në vazhdimësi dhe në tërësi komplet analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.
 2. Subjekti i rivlerësimit ka justifikuar mjaftueshëm burimet e tij të ligjshme financiare, duke e zbehur kështu balancën financiare negative në kufij të pranueshëm, për të cilën trupi gjykues mban në konsideratë parimin e proporcionalitetit që shkon në favor të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu nuk faktohet në asnjë rast fshehje pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit.

- b) Në lidhje me kriterin e figurës dhe elementet përbërëse të tij, nga sa kam shpjeguar më sipër, nuk ka elemente të mjaftueshme dhe bindëse që ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për shkarkimin nga detyra.
- c) Në lidhje me kriterin profesional, krijoj bindjen se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal në vlerësimin e aftësive profesionale.
- d) Në lidhje me ndonjë situatë të pretenduar konflikti interesi, shumica e trupës gjyquese duhet të kishte mbajtur në konsideratë pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
- e) Në lidhje me vlerësimin tërësor të të tria kritereve, krijoj bindjen se problematikat e konstatuara nuk arrijnë deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, në përfundim votoj për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Taulant Tafa, bazuar në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

Olsi KOMICI
Anëtar (kundër)